LIGJ
Nr. 99/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 236, DATË 18.2.2010, "PËR MARRJEN NË KONTROLL TË SHOQËRIVE ME OFERTË PUBLIKE"[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 236, datë 18.2.2010, "Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 2 e nenit 1 ndryshohet, si më poshtë:

"2. Ky ligj zbatohet për:

a) ofertat e shpallura publikisht për marrjen në kontroll të aksioneve me të drejtë vote, të emetuara nga shoqëri publike me seli në Republikën e Shqipërisë, kur këto aksione, të gjitha apo një pjesë e tyre, janë të pranuara për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë;

b) ofertat e shpallura publikisht për marrjen në kontroll të aksioneve me të drejtë vote, të emetuara nga shoqëri publike me seli në Republikën e Shqipërisë, kur këto aksione, të gjitha apo një pjesë e tyre, janë të pranuara për tregtim në një treg të rregulluar në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose të Zonës Ekonomike Evropiane;

c) ofertat e shpallura publikisht për marrjen në kontroll të titujve me të drejtë vote, të emetuara nga shoqëri publike me seli në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose të Zonës Ekonomike Evropiane, kur këta tituj, të gjithë apo një pjesë e tyre, janë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë.".

Neni 2

Në nenin 2 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronja "gj" ndryshohet si më poshtë:

"gj) "Ofertë për marrje në kontroll" është oferta e shpallur publikisht, e ndryshme nga oferta e bërë nga vetë shoqëria, objekt i ofertës, që u drejtohet zotëruesve të titujve të një shoqërie për marrjen në zotërim të të gjithë ose një pjese të këtyre titujve, qoftë e detyrueshme ose vullnetare, e cila pason ose ka si objektiv marrjen e kontrollit të shoqërisë, objekt të ofertës, sipas përcaktimeve të këtij ligji.".

2. Pas shkronjës "n" shtohet shkronja "n/1" me këtë përmbajtje:

"n/1) "Tituj me votim të shumëfishtë" nënkuptojnë tituj të përfshirë në një klasë të veçantë e të ndarë dhe që i japin mbajtësit më shumë se një votë për secilin titull.".

3. Pas shkronjës "o" shtohen shkronjat "p" dhe "q" me këtë përmbajtje:

---

[1] Ky ligj është i përafruar plotësisht me:
direktivën 2004/25/KE e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 21 prill 2004, lidhur me ofertat e marrjes në kontroll (*takeover bids*), FZ L 142, 30.4.2004, f. 12–23, CELEX: 32004L0025, ndryshuar kryesisht nga:
i. rregullorja (KE) nr. 219/2009, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 11 mars 2009, FZ L 87, 31.3.2009, CELEX: 32009R0219; ii. direktiva 2014/59/BE (BRRD), e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 15 maj 2014; FZ L 173, 12.6.2014; CELEX: 32014L0059; neni 119; iii. rregullorja (BE) 2021/23, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 16 dhjetor 2020, mbi kornizën e rimëkëmbjes dhe rezolucionit të qendrave të kliringut, që, ndër të tjera, ndryshon direktivën 2004/25/KE, FZ L 22, 22.1.2021, f. 1–102; dhe iv. direktiva (BE) 2023/2864, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 dhjetor 2023, që ndryshon disa direktiva për sa i përket krijimit dhe funksionimit të ESAP-it (përfshirë shtimin e nenit 16a në direktivën 2004/25/KE), FZ L, 20.12.2023; CELEX: 32023L2864.

“p) “Shtetet anëtare” janë shtetet e Bashkimit Evropian ose të Zonës Ekonomike Evropiane;

q) “ESAP-i” është pika e vetme e aksesit evropian, e krijuar sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian, që siguron akses elektronik të centralizuar në informacionet publikisht të disponueshme me rëndësi për shërbimet financiare, tregjet e kapitalit dhe qëndrueshmërinë.”.

Neni 3

Në shkronjën “d”, të nenit 3 pas fjalëve “në interesin më të mirë të shoqërisë, si një e tërë” shtohen fjalët “dhe nuk u mohon aksionarëve mundësinë për të vendosur mbi të mirat që sjell oferta.”.

Neni 4

Në nenin 7 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Shkronja “e”, e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“e) për llojin dhe masën e kundërvlerës së ofruar për çdo titull ose kategori titujsh dhe, në rastin e një oferte të detyrueshme, metodën e përdorur për përcaktimin e kundërvlerës, si dhe të dhëna të hollësishme për mënyrën, afatin dhe procedurën e pagesës së saj.”.

2. Pas shkronjës “j”, të pikës 2 shtohet shkronja “k” me këtë përmbajtje:

“k) të dhëna të detajuara për mënyrën e pagesës së dëmshpërblimit për çdo humbje të shkaktuar si rezultat i zbatimit të normave nga Asambleja e Përgjithshme, sipas neneve 16, pika 1/1, dhe 17, pika 1, të ligjit, dhe metoda e përdorur për përcaktimin e tij.”.

Neni 5

Në nenin 13 bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2 me këtë përmbajtje:

“1/1. Nëse, pasi oferta bëhet publike dhe para se oferta të mbyllet për pranimin, ofertuesi ose ndonjë person që vepron në bashkëpunim me të blen aksione të të njëjtit lloj apo kategori me një çmim më të lartë se çmimi i ofertës, ofertuesi duhet të rrisë ofertën e tij/saj në mënyrë që të mos jetë më e ulët se çmimi më i lartë i paguar për aksionet e kësaj natyre. Rritja publikohet dhe i njoftohet menjëherë Autoritetit, në përputhje me nenet 6 dhe 21 të këtij ligji, ka efekt për të gjithë mbajtësit e aksioneve dhe zbatohen pikat 2 e 3 të nenit 19 të këtij ligji;

1/2. Autoriteti, me vendim të arsyetuar, mund të përcaktojë një çmim të ofertës më të lartë ose më të ulët, kur vlerëson se çmimi nuk pasqyron në mënyrë reale dhe objektive vlerën e aksioneve, kur:

a) çmimi më i lartë është përcaktuar në bazë të një marrëveshjeje ndërmjet blerësit dhe shitësit që nuk pasqyron kushtet normale të tregut;

b) çmimi i tregut të aksioneve është ndikuar nga veprime manipuluese ose nga praktika të tjera që shtrembërojnë funksionimin normal të tregut;

c) çmimi i tregut të aksioneve në përgjithësi është ndikuar nga ngjarje të jashtëzakonshme ose rrethana të veçanta që cenojnë formimin normal të çmimit; ose

ç) rregullimi i çmimit është i nevojshëm për të mundësuar shpëtimin ose ristrukturimin e një shoqërie në vështirësi.

Në përcaktimin e çmimit të ofertës, sipas kësaj pike, Autoriteti merr në konsideratë, sipas rastit, një ose disa nga këto kritere objektive vlerësimi:

i. çmimin mesatar të ponderuar të tregut të aksioneve gjatë një periudhe të caktuar para lindjes së detyrimit për ofertë;

ii. vlerën e shoqërisë sipas aktiveve neto, pasqyrave financiare ose vlerës së ndarjes së saj;

iii. çmimet e paguara për transaksione të krahasueshme për të njëjtat aksione;

iv. vlerësimin e kryer sipas metodave të pranuara të analizës financiare.

Vendimi i Autoritetit për përcaktimin e çmimit të ofertës duhet të jetë i arsyetuar, të specifikojë kriteret e përdorura dhe të bëhet publik.”.

2. Në fund të pikës 4, shtohen fjalët “deri në përfundimin e periudhës së pranimit të ofertës.”.

Neni 6

Në nenin 16 bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Për këtë qëllim, Asambleja thërret një mbledhje brenda një periudhe të shkurtër, me kushtin që kjo mbledhje të mos mbahet brenda dy javëve nga njoftimi ofertës.".

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Në mbledhjen e përgjithshme të aksionarëve të thirrur për të vendosur për masat mbrojtëse, sipas pikës 1 të këtij neni:

a) nuk kanë efekt kufizimet mbi ushtrimin e së drejtës së votës, të parashikuara në statutin e shoqërisë, objekt të ofertës;

b) nuk kanë efekt kufizimet mbi ushtrimin e së drejtës së votës, të parashikuara në marrëveshje ndërmjet shoqërisë, objekt të ofertës, dhe mbajtësve të titujve të saj ose në marrëveshje ndërmjet vetë mbajtësve të titujve të saj, të lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij ligji;

c) aksionet me të drejtë votimi të shumëfishtë llogariten me një votë secili.".

3. Në fund të fjalisë së shkronjës "c", të pikës 2 shtohen fjalët "dhe, në çdo rast, vijimi i zbatimit të vendimeve në fjalë duhet të konfirmohet nga Asambleja e Përgjithshme.".

Neni 7

Në nenin 17 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "b", e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"b) kur pas një oferte për marrjen në kontroll ofruesi ka 75% ose më shumë të kapitalit me të drejtë vote, ai ka të drejtë të thërrasë mbledhjen e parë të përgjithshme të aksionarëve pas mbylljes së ofertës, e njoftuar në një periudhë të shkurtër, me kusht që mbledhja të mos mbahet brenda dy javëve nga njoftimi, me qëllim për të bërë shtesa dhe ndryshime në statut apo për të shkarkuar ose emëruar anëtarë të administratës. Në këtë mbledhje nuk zbatohen:

i. kufizimet për kalimin e aksioneve, të përmendura në shkronjën "a" të kësaj pike, dhe kufizimet për të drejtat e votës;

ii. të drejtat e jashtëzakonshme të aksionarëve për emërimin apo shkarkimin e anëtarëve të këshillit, të parashikuara në statutin e shoqërisë tregtare, objekt i ofertës;

iii. aksionet me të drejtë votimi të shumëfishtë, të cilat llogariten me një votë secili.".

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Dispozitat e pikës 1/1, të nenit 16 dhe të pikës 1 të këtij neni, lidhur me kufizimet mbi të drejtat e votës nuk zbatohen për titujt për të cilët këto kufizime kompensohen me përfitime të veçanta pasurore.".

3. Fjalia e parë, e pikës 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Kur në bazë të pikës 1 të këtij neni dhe të pikës 1/1, të nenit 16 u janë shkelur të drejtat, zotëruesit e këtyre të drejtave mund t'i kërkojnë ofruesit dëmshpërblim për çdo humbje të shkaktuar.".

Neni 8

Pas pikës 3, të nenit 18 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Çdo masë që zbatohet në përputhje me pikat 1 e 2 të këtij neni i nënshtrohet autorizimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, objekt oferte, i cili duhet të jetë dhënë jo më herët se 18 (tetëmbëdhjetë) muaj përpara publikimit të ofertës për marrjen në kontroll.".

Neni 9

Pas fjalisë së parë, të pikës 2, të nenit 25 shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

"Pas një oferte vullnetare, në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kundërvlera e përcaktuar në ofertë prezumohet të jetë e drejtë, kur, nëpërmjet pranimit të ofertës, ofertuesi ka fituar tituj që përfaqësojnë jo më pak se 90% të kapitalit me të drejtë vote të përfshirë në ofertë.

Pas një oferte të detyrueshme, kundërvlera e përcaktuar në ofertë prezumohet të jetë e drejtë.”.

Neni 10

Pas pikës 4, të nenit 29, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Detyrimi për paraqitjen e ofertës së detyrueshme nuk zbatohet edhe kur ndaj shoqërisë, objekt të ofertës, ofertuesit ose personave që veprojnë në bashkëpunim me ta zbatohen instrumentet ose kompetencat për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon rimëkëmbjen e ndërhyrjen e jashtëzakonshme.”.

Neni 11

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 30

Kompetenca e Autoritetit

1. Autoriteti është kompetent për mbikëqyrjen, e:

a) zbatimit të dispozitave të këtij ligji, nëse aksionet me të drejtë vote të një shoqërie publike me seli në Republikën e Shqipërisë, objekt i ofertës, janë listuar në tregun e rregulluar në Republikën e Shqipërisë;

b) zbatimit të dispozitave të nenit 35 të këtij ligji, nëse aksionet me të drejtë vote të një shoqërie publike me seli në Republikën e Shqipërisë, objekt i ofertës, janë listuar në tregun e rregulluar të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian ose të Zonës Ekonomike Evropiane;

c) zbatimit të dispozitave të nenit 36 të këtij ligji, nëse titujt me të drejtë vote të një shoqërie publike me seli në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian ose të Zonës Ekonomike Evropiane, objekt i ofertës, janë listuar për tregtim në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë.

2. Në rast se dokumenti i ofertës është subjekt i miratimit paraprak nga një autoritet mbikëqyrës i një shteti anëtar dhe është miratuar, ai do të njihet pa pasur nevojë për miratimin e Autoritetit. Autoriteti mund të kërkojë informacion pranë autoritetit mbikëqyrës që ka miratuar ofertën, në rastin kur ky informacion është specifik për tregun ku titujt e kompanisë së ofruar janë të pranuar për tregtim dhe lidhet me proceset që duhen respektuar për të pranuar ofertën e për të marrë shumën e kundërvlerës në mbyllje të ofertës, si dhe me rregullat tatimore që zbatohen për shumën e ofruar për mbajtësit e titujve.

3. Autoriteti bashkëpunon me autoritetet mbikëqyrëse të shteteve anëtare që mbikëqyrin instrumentet financiare dhe shkëmben informacion për zbatimin e rregullave të këtij ligji. Ky bashkëpunim përfshin, kur është e nevojshme, përcjelljen dhe njoftimin e dokumenteve ligjore të kërkuara për zbatimin e masave të marra nga autoritetet kompetente, lidhur me ofertat për marrje në kontroll, koordinimin për zbatimin e këtyre masave, si dhe dhënien e çdo ndihme tjetër të arsyeshme, të kërkuar për hetimin e shkeljeve të konstatuara ose të pretenduara të rregullave të zbatueshme për ofertat për marrje në kontroll. Informacioni i shkëmbyer i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional, në përputhje me legjislacionin në fuqi për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Shoqëria, objekt i ofertës, dhe ofertuesi janë të detyruar që në çdo kohë, me kërkesë të Autoritetit, t’i vënë në dispozicion të gjithë informacionin dhe dokumentet që zotërojnë lidhur me ofertën, kur ky informacion është i nevojshëm për përmbushjen e funksioneve mbikëqyrëse të Autoritetit, sipas këtij ligji.

5. Autoriteti, në rrethana të interesit publik ose të rasteve të jashtëzakonshme të tregut, që përfshijnë fatkeqësi natyrore, kufizim të lëvizjes sipas protokolleve shëndetësore, sulme kibernetike, prishje të infrastrukturës së tregut, që pengojnë shpalljet brenda afateve, si dhe ristrukturime me vendime gjyqësore apo masa në kuadër të rimëkëmbjes dhe të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, me vendim të arsyetuar, mund të bëjë përjashtime të kufizuara nga rregullat e këtij ligji, duke respektuar parimet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji.

6. Autoriteti me rregullore miraton:

a) format e veprimit në mënyrë të përbashkët;

b) llogaritjen e numrit e të përqindjes së të drejtave të votës;

c) sigurimin e shpërblimit;

ç) procedurat për marrjen e masave për parandalimin dhe eliminimin e të metave, që mund të lindin gjatë procedurës së ofertës për marrjen në kontroll;

d) procedurat për trajtimin e ankesave.".

Neni 12

Në nenin 34 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën "a", të pikës 1 pas nënndarjes "v" shtohet nënndarja "vi" me këtë përmbajtje:

"vi. pikën 2 të nenit 36/2 të këtij ligji;".

2. Pas shkronjës "e", të pikës 1 shtohen shkronjat "ë" dhe "f" me këtë përmbajtje:

"ë) moszbatimi nga ofertuesi i detyrimit për të rritur çmimin e ofertës, sipas pikës 1/1, të nenit 13 të këtij ligji;

f) kryerja e një mase mbrojtëse, sipas pikave 1 ose 2, të nenit 18 të këtij ligji, pa autorizimin paraprak të Asamblesë së Përgjithshme, në kundërshtim me pikën 4 të po këtij neni.".

3. Në shkronjën "a", të pikës 2 pas fjalës "e" shtohen fjalët "dhe "ë"".

4. Në shkronjën "b", të pikës 2 pas fjalës "v" shtohet fjala "vi", si dhe pas togfjalëshit "të shkronjës "a"" shtohet togfjalëshi "si dhe në shkronjën "f"".

Neni 13

Pas nenit 36 shtohen nenet 36/1 dhe 36/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 36/1

Raportimet te Komisioni Evropian

1. Autoriteti është pika kombëtare e kontaktit dhe koordinon zbatimin e detyrimeve të raportimit ndaj Komisionit Evropian (në vijim Komisioni) në fushën e ofertave për marrje në kontroll.

2. Brenda 3-mujorit të parë të çdo viti kalendarik, Autoriteti i përcjell Komisionit një raport për ofertat e marrjes në kontroll të përfunduara ose të ndërmarra gjatë vitit pararendës, që lidhen me shoqëri, titujt e të cilave janë të pranuar në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë. Raporti përfshin të paktën:

a) numrin e ofertave dhe rezultatin e secilës;

b) identifikimin e ofertuesit dhe të shoqërisë objekt;

c) çmimin e ofertës dhe përqindjen e kapitalit/votave të fituar/a;

ç) masat mbrojtëse të marra nga administrimi i shoqërisë objekt dhe rezultatet e tyre;

d) ushtrimin e të drejtave sipas neneve 25 e 26 të këtij ligji, nëse ka;

dh) çdo të dhënë tjetër të kërkuar nga udhëzimet e Komisionit ose nga aktet nënligjore vendase.

3. Autoriteti njofton Komisionin, për:

a) masat për sanksionet e zbatueshme për shkeljet e këtij ligji, si dhe çdo ndryshim të mëvonshëm;

b) caktimin e autoriteteve kompetente dhe për çdo ndarje funksionesh ndërmjet tyre, si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm, kur është e zbatueshme;

c) tekstin e dispozitave kryesore në fushën e këtij ligji, masat e rrepta dhe masat nga transpozimet, si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm.

"Neni 36/2

Pika e Vetme e Aksesit Evropian (ESAP)

1. Autoriteti është organi kompetent për mbledhjen e informacionit sipas këtij neni, me qëllim bërjen e tij të aksesueshëm në Pikën e Vetme të Aksesit Evropian (ESAP).

2. Subjektet që sipas këtij ligji kanë detyrimin të bëjnë publik informacionin e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni e publikojnë atë dhe ia paraqesin njëkohësisht Autoritetit.

3. Informacioni që paraqitet pranë Autoritetit, përfshin:

a) përcaktimin e autoritetit mbikëqyrës kompetent nga shoqëria objekt i ofertës, kur titujt e saj janë pranuar njëkohësisht për tregtim në tregje të rregulluara në më shumë se një shtet anëtar, sipas nenit 36, pika 2, të këtij ligji;

b) vendimin për të bërë ofertën për marrjen në kontroll, sipas nenit 6, pika 2, të këtij ligji;

c) dokumentin e ofertës, të përgatitur dhe të publikuar sipas nenit 7, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji;

ç) dokumentin që përmban opinionin e arsyetuar të administratës së shoqërisë objekt i ofertës mbi ofertën, përfshirë vlerësimin e pasojave të zbatimit të saj mbi interesat e shoqërisë, punësimin, kushtet e punës dhe vendndodhjen e veprimtarive të shoqërisë, si dhe opinionin e këshillit të punëmarrësve, nëse ka, sipas nenit 14, pikat 1 deri në 3, të këtij ligji.

4. Informacioni i përcaktuar në pikën 3 dhe i paraqitur sipas pikës 2 të këtij neni:

a) përgatitet në një format të dhënash të nxjerrshëm, sipas nenit 2, pika 3, të Rregullores (BE) 2023/2859 ose, kur kërkohet nga legjislacioni i Bashkimit Evropian, në një format të lexueshëm nga makina, sipas nenit 2, pika 4, të së njëjtës Rregullore;

b) shoqërohet me këto meta të dhëna:

i. të gjithë emrat e shoqërisë së cilës i referohet informacioni;

ii. identifikuesin e personit juridik (LEI) të shoqërisë, sipas nenit 7, pika 4, shkronja "b", të Rregullores (BE) 2023/2859;

iii. kategorinë e madhësisë së shoqërisë, sipas nenit 7, pika 4, shkronja "d", të Rregullores (BE) 2023/2859;

iv. sektorin ose sektorët ku përfshihen veprimtaritë ekonomike të shoqërisë, sipas nenit 7, pika 4, shkronja "e", të Rregullores (BE) 2023/2859;

v. llojin e informacionit, sipas klasifikimit të përcaktuar në nenin 7, pika 4, shkronja "c", të Rregullores (BE) 2023/2859;

vi. treguesin nëse informacioni përmban të dhëna personale.

5. Shoqëritë që kanë detyrimin për paraqitjen e informacionit sipas pikës 2 të këtij neni pajisen me identifikuesin e personit juridik (LEI).

6. Autoriteti bën të aksesueshme në ESAP vendimet e tij për rregullimin e çmimit të drejtë, sipas nenit 13, pika 1/2, të këtij ligji.

7. Informacioni i përcaktuar në pikën 6 të këtij neni:

a) përgatitet në një format të dhënash të nxjerrshëm, sipas nenit 2, pika 3, të Rregullores (BE) 2023/2859;

b) shoqërohet me këto meta të dhëna:

i. të gjithë emrat e shoqërisë me të cilën lidhet informacioni;

ii. identifikuesin e personit juridik (LEI) të shoqërisë, kur është i disponueshëm, sipas nenit 7, pika 4, shkronja "b", të Rregullores (BE) 2023/2859;

iii. llojin e informacionit sipas klasifikimit të përcaktuar në nenin 7, pika 4, shkronja "c", të Rregullores (BE) 2023/2859;

iv. treguesin nëse informacioni përmban të dhëna personale.

8. Autoriteti i transmeton ESAP-it informacionin dhe meta të dhënat e mbledhura sipas këtij neni, në përputhje me Rregulloren (BE) 2023/2859, aktet zbatuese të miratuara në bazë të saj dhe aktet nënligjore të miratuara nga Autoriteti për këtë qëllim.".

Neni 14

Pas nenit 37 shtohet neni 37/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 37/1

1. Neni 1, pika 2, shkronjat “b” dhe “c”, neni 30, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, pika 2 e pika 3, neni 36/1 dhe neni 36/2 të këtij ligji i fillojnë efektet juridike në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian ose në Zonën Ekonomike Evropiane.

2. Autoriteti është kompetent për zbatimin e dispozitave të këtij ligji në tërësi, në të gjitha rastet kur shoqëria, objekt oferte, ka selinë e regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe/ose marrja në kontroll zbatohet në një treg të rregulluar në Republikën e Shqipërisë, përveç dispozitave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, të cilat zbatohen vetëm pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Pas kësaj date, Autoriteti zbaton kompetencat e parashikuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të nenit 30 të këtij ligji.”.

Neni 15
Dispozita të fundit

Kudo në tekstin e ligjit fjalët:

a) “ligjin/t nr. 9879, datë 21.2.2008, “Për titujt”” zëvendësohen me fjalët “legjislacionin në fuqi që rregullon tregjet e instrumenteve financiare”;

b) “ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”” zëvendësohen me fjalët “legjislacionin në fuqi që rregullon regjistrimin e biznesit”;

c) “ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”” zëvendësohen me fjalët “legjislacionin në fuqi që rregullon mbrojtjen e konkurrencës”;

ç) “treg i organizuar” zëvendësohen me fjalët “treg i rregulluar”.

Neni 16
Shfuqizime

Në pikën 1, të nenit 36 fjalët “si dhe dispozitat e tjera të ligjit për shoqëritë tregtare” hiqen.

Neni 17
Aktet nënligjore

Për nxjerrjen e akteve nënligjore, sipas pikës 5, të nenit 30, të ligjit nr. 10 236, datë 18.2.2010, “Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike” ngarkohet Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.9.2026.

Shpallur me dekretin nr. 520, datë 9.10.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj